



DELEGACIONI I KOSOVËS AVOKON PËR ANËTARËSIM NË KËSHILLIN E EVROPËS

FAQE 4-5

Një delegacioni i Kosovës, i drejtuar nga kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca, ndodhet në Strasburg të Francës, për të avokuar për anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Evropës (KiE). Në mes të takimeve kyçe që delegacioni ka marrë pjesë ishte diskutimi në Komitetin e Çështjeve Politike dhe Demokracisë, ku Konjufca ka paraqitur rastin e Kosovës për anëtarësim në Këshillin e Evropës. "Rruga e Kosovës drejt anëtarësimit në Këshillin e Evropës është shënuar nga përkushtimi dhe përpjekimi. Vlerësoj mbështetjen dhe njohjen e vazhdueshme nga bashkësia evropiane", ka thënë kryeparlamentari Konjufca.



KURTI PARAQET PRIORITETET E MINISTRIVE PËR VITIN 2024, THOTË SE KOSOVA DO T'I RRIË KAPACITETET MBROJTËSE

F.3



AMBASADORI I BE-së THOTË SE VENDIMET E GJYKATËS KUSHTETUESE DUHET TË ZBATOHEN PLOTËSISHT

F.7

OSMANI NË TAKIM ME MINISTRIN ÇEK: ANËTARËSIMI NË KE, NË INTERES TË TË GJITHË QYTETARËVE PA DALLIM

F.3

KOSOVA DHE SERBIA DO TË VLERËSOHEN INDIVIDUALISHT NGA FONDI I BE-së PËR RITJE EKONOMIKE

F.7

LDK-ja: QEVERIA KURTI, E PAAFTË DHE ARROGANTE

F.6

EKONOMI



QYTETARËT E KOSOVËS GJATË MUJIT DHJETOR MORËN 193 MILIONË EURO KREDI

F.6

SHBA-ja KËRKON RISHQYRTIM TË VENDIMIT PËR DINARIN, BISLIMI THOTË SE KUSHTETUTA DUHET TË ZBATOHET NË TËRËSI

F.8

SPORT



TEMPERATURA APO POLITIKA: PSE NUK LUAJTËN VOLEJBOLLISTËT E KOSOVËS DHE SERBISË?

F.10

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Buniamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVO
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Parlamenti turk miraton anëtarësimin e Suedisë në NATO

ANKARA, 24 JANAR - Deputetët turq kanë ratifikuar kërkesën e Suedisë për anëtarësim në NATO, duke e bërë edhe më të afërt hyrjen e këtij vendi në aleancë.

Suedia, bashkë me Finlandën, u kanë dhënë fund disa dekadave neutralitet më 2022, dhe kanë vendosur t'i bashkohen NATO-s pas nisjes së luftës së Rusisë në Ukrainë.

Teksa Finlanda është pranuar, Suedisë i është penguar rruga nga Turqia, e ka pasur disa mospajtime me Suedinë lidhur me atë që e ka konsideruar përkrahje të Stokholmit për separatistët kurdë, duke



përmendur pjesëtarë të Partisë Popullore të Kurdistanit (PKK).

Turqia, bashkë me Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimin

Evropian, e konsiderojnë PKK-në organizatë terroriste.

Presidenti turk Rexhep Tajip Erdogan tani pritet ta

nënshkruajë legjislacionin për Suedinë brenda ditëve.

Kjo nënkupton që Hungaria do të jetë anëtarja e vetme e NATO-s që do të duhet ta miratojë kërkesën e Suedisë që të finalizohet procesi.

Kryeministri suedez Ulf Kristersson ka thënë pas votimit në Turqi se vendi i tij tani është një hap afër NATO-s.

Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, e ka mirëpritur lajmin nga Turqia, duke thënë se pret që edhe Hungaria t'u japë fund procedurave sa më shpejt që është e mundur.

Hungaria e ka akuzuar Suedinë

se ka qasje armiqësore.

Në mars të vitit të kaluar zëdhënësi i qeverisë hungareze, Zoltan Kovacs, i ka akuzuar zyrtarët në Suedi se po qëndrojnë në fronin e superioritetit moral, pasi Stokholmi e ka akuzuar më parë qeverinë hungareze se po rrëshqet kundër parimeve demokratike të BE-së. Megjithatë, ditët e fundit ka pasur përparim.

Kryeministri hungarez Viktor Orban ka thënë të martën se e ka ftuar homologun e tij suedez në Budapest për të biseduar për anëtarësimin e Suedisë në NATO.

CIA tenton të rekrutojë agjentë të dyfishtë në Rusi

UASHINGTON, 24 JANAR - Agjencia Qendrore amerikane e Intelgjencës (CIA) ka publikuar një video në gjuhën ruse, në tentim për t'i bindur punonjësit rusë të inteligjencës që të punojnë si agjentë të dyfishtë për Uashingtonin.

Drejtori i CIA-s, William Burns, ka deklaruar korrikun e vitit të kaluar se ka pakënaqësi në mesin e disa rusëve lidhur me luftën në Ukrainë dhe kjo pakënaqësi krijon mundësi për të rekrutuar spiunë dhe CIA do ta shfrytëzojë këtë situatë.

Videoja, e publikuar në kanalet zyrtare të CIA-s në rrjetet sociale,

tenton të bindë ata që sugjeron se janë patriotë rusë që punojnë për shërbimet e inteligjencës dhe mund të ndihen të tradhtuar nga ajo që u cilësua si korrupsion në qarqet e elitës dhe mënyrës së dobët se si forcat e armatosura ruse janë të pajisura dhe furnizuara. "Ata që janë përreth jush ndoshta nuk duan ta dëgjojnë të vërtetën, por duam ne. Ju nuk jeni të pafuqishëm", thuhet në videon që është e fundit në serinë e videove rekrutuese që shënjestrojnë Rusinë. Më pas në video shfaqen mënyrat se si të kontaktohet CIA. E shoqëruar me një muzikë

melankolike, personazhi kryesor i videos, një personazh fiktiv, burrë 35 vjeç, shfaqet si një punonjës i agjencisë ushtarake të inteligjencës së Rusisë i cili e portretizon veten si patriot që e do Rusinë dhe që më parë ka shërbyer si parashutist. "A keni guxim të mjaftueshëm që të përballeni me këtë tradhti", thotë ai në video, para se ai të kuptojë se armiku i vërtetë brenda Rusisë është një formë e korruptuar e udhëheqjes.

Ky personazh fiktiv më pas thotë se për shkak të patriotizmit të tij ai ka vendosur të veprojë dhe të punojë me CIA-n.



OBSH-ja raporton për rritje të rasteve me fruth në Evropë



GIJENEVË, 24 JANAR - Evropa ka regjistruar 30 000 raste me fruth vitin e kaluar, apo 30 herë më shumë raste se vitin 2022, tha Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH), duke bërë thirrje për një fushatë "urgjente" të vaksinimit. "Ne kemi në rajon jo vetëm rritje 30-fish më të lartë të rasteve me fruth, por pothuajse 21 000 hospitalizime dhe pesë vdekje të lidhura me fruthin. Kjo është shqetësuese", tha OBSH-ja. Rajoni i Evropës që OBSH-ja mbulon përfshin 53 shtete,

përfshirë Rusinë dhe Azinë Qendrore. Dyzet shtete kanë regjistruar raste me fruth më 2023, tha organizata.

Rusia dhe Kazakistani kanë regjistruar më së shumti raste, përkatësisht nga 10 000 raste secila. Evropa Perëndimore, Britania, po ashtu, kanë regjistruar 183 raste.

Niveli i vaksinimit kundër sëmundjes ka rënë gjatë pandemisë Covid-19 dhe "përpjekjet urgjente për vaksinim janë të nevojshme në mënyrë që

të ndalet transmetimi dhe të parandalohet shpërndarja e mëtejme".

Afër 1.8 milion foshnja në rajonin e Evropës që mbulon OBSH-ja nuk ishin vaksinuar mes viteve 2020 dhe 2022. "Është e rëndësishme që të gjitha shtetet me shpejtësi t'i detektojnë rastet dhe të përgjigjen shpejt ndaj shpërthimeve të fruthit, të cilat mund ta vënë në rrezik përparimin e bërë drejt eliminimit të fruthit", tha OBSH-ja. Niveli i vaksinimit kundër fruthit ka rënë në nivel botëror.

BE-ja propozon masa kundër dezinformimit në prag të zgjedhjeve

BRUKSEL, 24 JANAR - Përfaqësuesi i lartë për politikë të jashtme dhe siguri i Bashkimit Evropian, Josep Borrell, paraqiti raportin e Shërbimit të veprimit të jashtëm lidhur me fushatat e ndërhyrjes së huaj dhe dezinformimit me qëllim të ndikimit në proceset zgjedhore.

Borrell ka theksuar se ky raport vjen në një kohë të ndjeshme dhe të rëndësishme, pasi këtë vit në shumë vende të botës, përfshirë edhe në BE dhe Shtetet e Bashkuara, do të ketë procese zgjedhore. Me këtë raport Borrelli ka propozuar edhe masa që duhet të ndërmerren për t'i parandaluar ndikimet

negative në proceset demokratike nga faktorët që kanë për qëllim manipulimin dhe dezinformimin. Gjatë paraqitjes së raportit shefi i diplomacisë së BE-së tha se kërcënimi nga ndikimet e huaja në botën moderne janë kërcënime gjithnjë e më të mëdha të cilat duhet të merren seriozisht.



Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ

• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQRIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)

• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut

• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

24 vjet nga themelimi i gazetës “Epoka e re”

PRISHTINË, 24 JANAR - Gazeta e përditshme “Epoka e re” është themeluar më 15 dhjetor 1999, por numri i saj i parë ka dalë më 25 janar 2000.

Sot (e enjte) “Epoka e re” ka mbushur 24 vjet që nga numri i parë.

Pas fillimit të pandemisë Covid-19 u ndal botimi i

medieve të shtypura.

Sot Kosova vazhdon të jetë vendi i vetëm në botë pa gazetë të shtypur ditore.

“Epoka e re” botohet online <https://www.epokaere.com> dhe në formatin PDF.

Në formatin PDF sot është botuar numri i 7 100 i “Epokës së re”.

Botues i gazetës “Epoka e re”

është Muhamet Mavraj, personalitet i njohur i demonstratave studentore të vitit 1997.

“Epoka e re” shquhet për kuadrin e saj kritik gazetaresk, i cili synon arritjen e një informacioni të ri në mjedisin shqiptar dhe formimin e audiencës kritike.

Osmani në takim me ministrin çek: Anëtarësimi në KE, në interes të të gjithë qytetarëve pa dallim

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

Prishtinë, 24 janar - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur të mërkurën në takim ministrin për Çështje Evropiane të Republikës Çeke, Martin Dvorak. Në fokus të diskutimit ndërmjet Osmani dhe ministrit Dvorak ishte situata aktuale politike dhe e sigurisë, forcimi i marrëdhënieve dypalëshe dhe stabiliteti rajonal.

Presidentja Osmani nënvizoi përkushtimin e palëkundur të Kosovës në rrugëtimin euroatlantik, duke theksuar domosdoshmërinë e anëtarësimit të Kosovës në Këshillin e Evropës, i cili është në interes të të gjithë qytetarëve të Kosovës pa dallim, përfshirjen në Partneritetin për Paqe, anëtarësimin në NATO, BE dhe organizata ndërkombëtare.

Më tej, presidentja Osmani shprehu mirënjohje për mbështetjen e vazhdueshme të

Çekisë në forcimin e pozitës ndërkombëtare të Kosovës. Duke nënvizuar vazhdimin e mbështetjes së Republikës Çeke në këtë rrugëtim, presidentja Osmani potencoi rëndësinë strategjike të përfshirjes së Kosovës në PEP, më pas në NATO, si një garanci për stabilitet jo

vetëm të Kosovës, por edhe të rajonit. Ndërlidhur me këtë, Osmani tha se Kosova meriton ta marrë statusin e vendit kandidat në BE, si vend që ka realizuar reforma rrënjësore.

Në takim me ministrin Dvorak, presidentja Osmani theksoi se sulmi terrorist dhe agresioni i 24 shtatorit në Banjskë, i mbështetur dhe sponsorizuar nga Serbia, ishte përpjekje për ta minuar paqen dhe stabilitetin jo vetëm të Kosovës, por të gjithë Ballkanit Perëndimor.

Më tutje, presidentja Osmani theksoi nevojën e heqjes së masave të BE-së ndaj Kosovës, të cilat janë të padrejta dhe krijojnë mungesë ekuilibri në dialog. Duke spikatur marrëdhëniet e kahershme pozitive ndërmjet Kosovës dhe Republikës Çeke, të dy bashkëbiseduesit diskutuan edhe për mundësitë e zgjerimit të bashkëpunimit në fusha të ndryshme të interesit të përbashkët.

Ambasadori i BE-së thotë se vendimet e Gjykatës Kushtetuese duhet të zbatohen plotësisht

PRISHTINË, 24 JANAR - Ambasadori i BE-së në Kosovë, Tomas Szunyog, i shoqëruar nga shefi i Misionit të

Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX), Giovanni Pietro Barbano,

ambasadori i Austrisë në Kosovë, Georg Schnetzer, ambasadori i Italisë në Kosovë, Antonello De Riu

dhe zëvendësambasadori i Francës, François Cyprien, janë takuar me kryetaren e Gjykatës

Kushtetuese të Kosovës, Gresa Caka-Nimani.

Gjatë takimit ambasadori Szunyog ritheksoi rëndësinë që BE-ja i jep rolit themelor të Gjykatës Kushtetuese në garantimin e supremacisë së Kushtetutës dhe në mbrojtjen e të drejtave dhe parimeve themelore në të.

Ambasadori i BE-së në Kosovë ka theksuar se Gjykata Kushtetuese duhet të jetë e pavarur dhe e lirë nga ndikimet dhe presionet politike. “Për ta mbështetur pavarësinë e gjyqësorit, është thelbësore që anëtarët e qeverisë të përmbahen nga deklaratat që rrezikojnë ta cenojnë autoritetin dhe pavarësinë e gjyqësorit, si dhe besimin e publikut në të”, ka theksuar Szunyog.

Në qendër të takimit ishte edhe nevoja që vendimet e Gjykatës Kushtetuese të respektohen dhe të zbatohen plotësisht, përfshirë edhe Aktgjykimin e datës 19 maj 2016 për rastin e Manastirit të Deçanit.



Delegacioni i Kosovës avokon për anëtarësim në Këshillin e Evropës

Një delegacioni i Kosovës, i drejtuar nga kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca, ndodhet në Strasburg të Francës, për të avokuar për anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Evropës (KiE). Në mes të takimeve kyçe që delegacioni ka marrë pjesë ishte diskutimi në Komitetin e Çështjeve Politike dhe Demokracisë, ku Konjufca ka paraqitur rastin e Kosovës për anëtarësim në Këshillin e Evropës. “Rruga e Kosovës drejt anëtarësimit në Këshillin e Evropës është shënuar nga përkushtimi dhe përparimi. Vlerësoj mbështetjen dhe njohjen e vazhdueshme nga bashkësia evropiane”, ka thënë kryeparlamentari Konjufca.

raporti i tyre objektiv dhe i përgatitur me shpejtësi ka ofruar perspektiva të vlefshme. “Falënderoj veçanërisht të tre raportuesit, përfshirë zonjën Bakoyannis për organizimin e vizitave në Kosovë në kohë të duhur. Në këtë fazë besojmë se PACE ka siguruar një vizion të qartë për Kosovën. Siç tregojnë raportet e juristëve të shquar, ‘rregullat ligjore janë në përgjithësi në përputhje me standardet ndërkombëtare, ose siç është rasti me Kushtetutën, shkojnë përtej këtyre standardeve’. Aplikimi ynë për anëtarësim daton që nga viti 2022. Kosova ka punuar për 16 vjet me instrumentet kyçe të Këshillit të Evropës dhe tashmë është anëtare e plotë e Komisionit të Venedikut dhe Bankës për Zhvillimin e Këshillit të Evropës”, ka theksuar Konjufca.

Kreu i Kuvendit shtoi se që nga viti 2008 Kosova ka dhënë një rang kushtetues dhe ka zbatuar drejtpërdrejt Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Konventën Kornizë për

Minoritetet dhe që nga viti 2020 edhe Konventën e Stambollit. “Ne vazhdojmë ta mbajmë përkushtimin për t’i mbrojtur standardet ndërkombëtare dhe për t’i promovuar të drejtat e njeriut. Rruga e Kosovës drejt anëtarësimit në Këshillin e Evropës është shënuar nga përkushtimi dhe përparimi. Vlerësoj mbështetjen dhe njohjen e vazhdueshme nga bashkësia evropiane”, ka deklaruar Konjufca.

Në kuadër të qëndrimit në Strasburg delegacioni u takua me personalitete të rëndësishme nga grupe të ndryshme politike, duke përfshirë Beatrice Fresko-Rolfo, raportuesen për Kosovën në Komitetin për Barazi dhe Mosdiskriminim, delegacionin kombëtar të Francës, kryetarin e Grupit ALDE, Iulian Bulai, si dhe deputetë dhe përfaqësues të përhershëm të vendeve anëtare. Konjufca, së bashku me anëtarët e tjerë të delegacionit, do të realizojnë edhe takime të tjera të rëndësishme gjatë kësaj vizite.

**EPOKA
ERE****Mal QORRAJ**

STRASBURG, 24 JANAR - Delegacioni i Kosovës, nën drejtimin e kryetarit të Kuvendit, Glauk Konjufca, ndodhet në Strasburg të Francës për të avokuar për anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Evropës (KiE).

Në delegacionin e kryeparlamentarit Konjufca janë dhe nënkryetarja Saranda Bogujevci në cilësinë e kryesueses së delegacionit të Kosovës në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës (APKE), deputetët

Arben Gashi, Enis Kervan, Arjana Musliu-Shoshi dhe Besnik Tahiri, si dhe zëvendësministri për Punë të Jashtme dhe Diasporë, Kreshnik Ahmeti.

Ky delegacion përfaqëson përkushtimin e spektrit politik të Kosovës për ta arritur anëtarësimin në KiE.

Në mes të takimeve kyçe që delegacioni ka marrë pjesë ishte diskutimi në Komitetin e Çështjeve Politike dhe Demokracisë, ku Konjufca ka paraqitur rastin e Kosovës për anëtarësim.

Në takim u diskutuan çështje të rëndësishme që afirmojnë të

arriturat e Kosovës në vitet e fundit dhe adresojnë rekomandimet nga raporti i juristëve eminentë.

Gjatë diskutimit të tij, kryeparlamentari Konjufca u përgjigj në pyetjet e adresuara dhe bashkëbisedoi me anëtarët e komitetit në lidhje me procesin e anëtarësimit të Republikës së Kosovës në Këshillin e Evropës.

Duke shprehur mirënjohje për këtë mundësi si dhe ndaj PACE, përfshirë Komitetin dhe Sekretariatin për veprimet e menjëhershme në emërimin e juristëve dhe raportuesve të shquar, Konjufca vlerësoi se

Kurti paraqet prioritetet e ministrive për vitin 2024, thotë se Kosova do t'i rrisë kapacitetet mbrojtëse

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 24 JANAR - Kryeministri Albin Kurti në mbledhjen e qeverisë të mbajtur të mërkurën ka paraqitur prioritetet për vitin 2024. Ai ka bërë me dije se Ministria e Punës, Financave dhe Transfereve këtë vit do ta vazhdojë reformën pensionale. Ndërkaq për Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Kurti ka thënë se angazhim prioritar do të jetë përmirësimi i ambientit për të bërë biznes nëpërmjet shërbimeve më të mira për biznese, mbrojtjes së pronësisë industriale dhe rritjes së mbikëqyrjes së tregut. “Përsheptimi i transformimit digjital dhe inovacionit te ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe ato fillestare përmes politikave për nxitjen e inovacionit dhe zhvillimin e industrisë drejt produkteve dhe shërbimeve me vlerë të shtuar, po ashtu, do të jenë prioritetet të ministrisë”, ka thënë ai.

Kryeministri ka theksuar se këtë vit, në mesin e planeve kryesore të Ministrisë së Ekonomisë në fushën e energjisë, është lansimi i ankandit të erës me kapacitet 150 MW në dy lote nga 75 MW. “Në të njëjtën kohë do t'i japim vëmendje të shtuar e të veçantë Trepçës dhe investimeve aty”, ka deklaruar Kurti.

Ai ka thënë se reforma në drejtësi është prioritet i qeverisë. “Vetingu po merr rrugë, pas aktgjykimit në fund të vitit që lamë pas nga Gjykata Kushtetuese. Ky proces, përveçse premtim, është domosdoshmëri që na dëshmohej çdo ditë. Krahastij, e tekta presim tash e 11 muaj për vendim të Gjykatës Kushtetuese për Ligjin për Byronë Shtetërore për Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme, luftën kundër korrupsionit në këtë vit do ta bëjmë edhe përmes themelimit të Byrosë për Konfiskimin Civil dhe funksionalizimit të Task-forcës Anti-korrupsion e të ekipeve të përbashkëta të hetimit. Adresimi i krimeve të kryera gjatë luftës si prioritet tjetër yni do të vijojë me funksionalizimin e Institutit për Krimet e Kryera gjatë Luftës në Kosovë por, gjithashtu, me finalizimin dhe miratimin e Strategjisë për Drejtësinë Tranzicionale. Paralelisht, Ministria e Drejtësisë do të fokusohet edhe në adresimin e dhunës në familje dhe përmirësimin e shërbimeve sociale dhe familjare, ndër të tjera përmes akteve të ndryshme nënligjore, zbatimit të masës për Punësimin e Viktimave të Dhunës dhe mbështetjes së qëndrueshme financiare për strehimoret dhe OJQ-të që ofrojnë shërbime sociale dhe familjare”, është shprehur Kurti.



“Numrin e ushtarëve e rritëm”

Ai ka bërë me dije se në vitin 2023 buxheti për mbrojtjen ishte më i larti ndonjëherë, mbi 200 milionë euro, apo më shumë se 2 % e Bruto Produktit Vendor që është kriter i NATO-s. “Numrin e ushtarëve e rritëm. Investimet në armatim, po ashtu. Ushtrinë e pajisëm edhe me dronë luftarakë Bayraktar. E tash në këtë vit, në përputhje me miratimin e buxhetit në fund të vitit të kaluar, rritja e kapaciteteve mbrojtëse do të jetë prioriteti i parë i Ministrisë së Mbrojtjes. Për një fillim të mbarë të vitit, në fillim të këtij viti ne morëm konfirmim nga Departamenti Amerikan i Shtetit se ka pranuar kërkesën tonë për ta blerë sistemin raketor antitank ‘Javelin’. E përgjatë vitit, krahas blerjeve të reja e investimeve të tjera, në fushën e mbrojtjes prioritet do të kemi edhe bashkëpunimin ndërkombëtar me miq, partnerë dhe aleatë”, ka thënë Kurti, duke shtuar se viti i kaluar ka qenë një vit sfidues, por gjithsesi i suksesshëm në fushën e sigurisë dhe çështjeve të brendshme. “Ministria e Punëve të Brendshme, e cila ka buxhetin më të lartë ndonjëherë, sivjet prioritet do ta ketë shtimin e kapaciteteve infrastrukturore, rritjen e kapaciteteve njerëzore dhe investimet në pajisje operationale të Policisë së Kosovës. Kurse në kuadër të administratës publike që, po ashtu, mbulon kjo ministri, synohet kompletimi i kornizës së akteve nënligjore të Ligjit për Zyrtarë Publikë dhe integrimi i shërbimeve të digjitalizuara në E-Kosova”, ka theksuar kryeministri.

“Viti 2024 ka filluar pa obligime dhe borxhe ndaj bujqve dhe fermerëve”

Duke folur tutje, ai ka pohuar se për bujqit dhe fermerët në vitin 2023 kishin buxhetin më të lartë

ndonjëherë, mbi 100 milionë euro. Ndërkaq, sipas tij, ky vit i ri ka filluar pa obligime dhe borxhe ndaj tyre. “Në fillim të muajit janar shpалosëm Programin për Pagesa Direkte për vitin 2024 me të cilin do të përkrahim 28 nënsektorë dhe kultura bujqësore. E zbatimi i tij do të jetë një nga prioritetet kryesore të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, së bashku me dy të tjera: atë të zbatimit të Programit për Zhvillim Rural dhe të procesit të akreditimit për Instrumentin e Asistencës së Para-Anëtarësimit (IPARD) të Bashkimit Evropian, ku i kemi siguruar 7 milionë euro. Në pjesën e parë të vitit pritet të fillojë edhe zbatimi i projektit për agroturizëm, ekoturizëm e zhvillim rural, me mbështetje direkte nga Qeverisë Gjermane në vlerë prej 20.2 milionë eurosh”, ka deklaruar ai.

Kurti ka folur edhe për kandidaturën e Kosovës për organizimin e Lojërave Mesdhetare 2030. “Ishte kryelajmi i vitit të kaluar jo vetëm për sportin”, ka thënë Kurti, derisa ka numëruar projektet për këtë vit në sport dhe kulturë. “Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal do të vazhdojë me financimin e ndërtimit dhe renovimit të shtëpive të komuniteteve joshumicë në komuna përmes të njëjtit program të cilin e filluam që ta zbatojmë vitin e kaluar krahas angazhimit për digjitalizim të sa më shumë shërbimeve elektronike nëpërmjet platformës e-Komuna, si dy prej prioritetëve të saj për këtë vit”, ka thënë kryeministri.

“Po forcohet subjektiviteti ndërkombëtar”

Ai ka theksuar se duke qenë se tashmë kemi kaluar me sukses fazën e parë të anëtarësimit në Këshillin e Evropës, anëtarësimi i plotë në këtë organizatë mbetet prej synimeve kryesore të politikës së jashtme,

përkatësisht Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës për këtë vit. “Ndërkohë që do të vazhdojë blerja e ndërtesave të reja për misionet tona diplomatike, krahas planifikimit për miratimin e tre ligjeve shumë të rëndësishme: i pari Ligji për Diasporën; i dyti Ligji për Protokollin e Shtetit; dhe i treti Ligji për Shërbimin e Jashtëm, si dhe rekrutimit të diplomatëve të rinj për fuqizimin e diplomacisë sonë anëmbanë globit. Viti 2024 ka filluar si është më së miri. Pas hyrjes në fuqi të liberalizimit të vizave, njohjes së pasaportës nga Spanja, e dekretit për hapjen e Misionit të Posaçëm të Kosovës në Selinë e Shenjtë në Vatikan, dje morëm edhe njoftimin zyrtar se nga 22 shkurti qytetarët tanë do të mund të udhëtojnë pa viza edhe në Emiratet e Bashkuara Arabe. Të gjitha këto forcojnë subjektivitetin tonë ndërkombëtar që, përveçse prioritet i këtij viti, ka qenë dhe është prioriteti programor i politikës sonë të jashtme”, ka thënë Kurti.

Duke folur për sektorin e arsimit, Kurti ka thënë se për këtë vit do të fokusohen në rritjen e përfshirjes dhe qasjes së barabartë në edukimin në fëmijërinë e hershme dhe furnizimin me pajisje teknologjike dhe digjitalizimin në arsimin parauniversitar. “Njëkohësisht, prioritet për Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit do të jetë ngritja e cilësisë së arsimit parauniversitar përmes konsolidimit të mekanizmave për sigurim të cilësisë, instrumenteve matëse dhe rritjes së numrit të inspektorëve, si dhe ndërlikohet së arsimit me tregun e punës duke e zgjeruar atë në kuadër të arsimit dual, që tashmë ka gjithsej 12 profile, të cilat po gjejnë zbatim në 21 shkolla, në 14 komuna të Kosovës. Në shëndetësi prioritet do të kenë investimet në pajisje moderne dhe infrastrukturore,

shtimi i shërbimeve në institucionet publike shëndetësore dhe sistemi informativ shëndetësor. Vitin që lamë pas shtuam disa shërbime të reja si sedacioni inhalator në stomatologji; ultrazëri endoskopik; shërbimi falas për rikonstruktimin e gjirit për pacientët e prekur nga kanceri, dhe diagnostikimi i retinopatisë te foshnjat e lindura para kohe me pajisjen e re në Klinikën e Oftalmologjisë. Kurse nga java e kaluar, për herë të parë filloi ofrimi i shërbimit të implantëve dentare në Qendrën Stomatologjike Universitare të Kosovës. Shërbimet e reja si këto u sigurojnë qëndrueshmëri institucioneve publike shëndetësore, ndërkaq qytetarëve shërbime cilësore me çmim të përballueshëm”, ka pohuar ai.

Sa i përket infrastrukturës rrugore, Kurti ka thënë se viti 2024 do të jetë vit i përfundimit të disa projekteve të vjetra dhe fillim i disa të reja. “Autostrada Prishtinë - Gjilan dhe rrugët Prishtinë - Podujevë, Prishtinë - Mitrovicë, Dollc - Gjakovë e Drenas - Skenderaj pritet të finalizohen sivjet. Paralelisht do të fillojë puna në autostradën Bresalc - Dheu i Bardh, në rrugën Kijevë - Zahaq, në rrugën nga autostrada ‘Ibrahim Rugova’ deri te hyrja në tunelin e rrugës Prizren - Tetovë dhe në rrugën Drenas - Kroni i Mbretit. Kurse sa i përket infrastrukturës hekurudhore, këtë vit pritet të bëhet hartimi i projekteve kryesore të linjave hekurudhore Prishtinë - Pejë dhe Klinë - Prizren, si dhe përfundimi i studimit të fizibilitetit dhe projektit ideor të linjës hekurudhore Prishtinë - Durrës. Ndërkaq, sot pasdite, së bashku me ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Liburn Aliu, do të marrim pjesë në ceremoninë zyrtare pas hapjes së korridoreve ajrore me Republikën e Shqipërisë, prioritet do ta kemi për të dhe ministrinë e tij, që këtë vit të jetë edhe hapja e korridoreve ajrore edhe me Malin e Zi. Ministria e Zhvillimit Rajonal këtë vit do të përqendrohet në kompletimin e kornizës ligjore dhe funksionalizimin e mekanizmave për zhvillim rajonal dhe rritjen e nivelit të zhvillimit socio-ekonomik. Kjo do të bëhet nëpërmjet hartimit të programit për zhvillim rajonal të balancuar dhe studimit të fizibilitetit për rajone zhvillimore me qëllim identifikimin e investimeve strategjike me ndikim socio-ekonomik rajonal”, ka thënë Kurti në mbledhjen e 182-të të Qeverisë së Kosovës.

Latifi pret në takim Isufin, diskutojnë për ecurinë e regjistrimit të popullsisë

RAHOVEC, 24 JANAR - Kryetari i komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka pritur në takim prof. dr. Florim Isufin, kryetar i Komisionit të Regjistrimit të Popullsisë, të Ekonomive Familjare dhe Banesave (REKOS 2024), i cili ishte i shoqëruar nga anëtarët e këtij komisioni, Kushtrim Krasniqi

dhe Agim Ferati. Latifi ka treguar se gjatë takimit diskutuan për ecurinë e procesit të përgatitjeve për Regjistrimin e Popullsisë, të Ekonomive Familjare dhe Banesave (REKOS 2024), i cili do të fillojë më 5 prill, si dhe ka shprehur gatishmërinë e plotë për mbështetje në realizimin

me sukses të regjistrimit të popullsisë, si një nga projektet më kapitale me interes kombëtar dhe shtetëror. "U pajtuam që të kemi koordinim sa më të ngushtë ndërmjet komunës së Rahovecit dhe ASK-së për suksesin e plotë të këtij projekti shumë të rëndësishëm", ka thënë Latifi.



Lansohet pilot-projekti që do të mbështesë sektorin e industrisë kreative në Kosovë



PRISHTINË, 24 JANAR - Në hapësirat e Ambasadës së Suedisë në Kosovë u lansua pilot-projekti që do të mbështesë sektorin e industrisë kreative në vend.

Të pranishëm ishin ministri Hajrulla Çeku, ambasadori i Suedisë në Kosovë, Jonas Westerlund, shefja e zyrës së bashkëpunimit në Universitetin e Lundit, Lisa Thelin, përfaqësues të UN Habitatit, të Anibarit dhe Future by Lund.

Në këtë ngjarje u shpalosën detajet e projektit që do t'i zhvillojë kapacitetet e inovacionit dhe modelet e bashkëpunimit ndërdisiplinar të sektorit të industrive kreative.

Gjatë fjalës së tij, ministri Çeku foli për rëndësinë e këtij projekti që do të asistojë në hartimin e strategjisë kombëtare për industritë kreative në Kosovë, e cila do të zhvillohet gjatë këtij viti.

Projekti mbështetet nga Ambasada Suedeze në Kosovë dhe zbatohet nga MKRS, Universiteti i Lundit, Future by Lund, UN Habitat dhe Anibar. Në shtator të vitit 2023 MKRS-ja kishte nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin e Lundit për t'i fuqizuar kapacitetet inovative të industrive kreative dhe për ta rrjetëzuar atë me zhvillimet në Evropë. Ky projekt vjen si vazhdimësi e këtij memorandumi.

LDK-ja: Qeveria Kurti, e paaftë dhe arrogante

PRISHTINË, 24 JANAR - Lidhja Demokratike e Kosovës ka mbajtur sot një konferencë për medie, në të cilën ka paraqitur, sipas saj, dështimet e qeverisë Kurti. Anëtar i Kryesisë së LDK-së, Berat Rukiqi, duke folur para medieve, tha se këto dështime burimin e kanë në paaftësinë dhe arrogancën e numrave të

kësaj qeverie. "Sot po paraqesim një pjesë të dështimeve të kësaj qeverie, në qeverisjen me ekonominë e vendit. Këto dështime, që burimin e kanë në paaftësinë dhe arrogancën e numrave, po i paguajnë shumë shtrenjtë qytetarët e vendit", ka thënë Rukiqi. Ai ka shtuar se Kurti është duke vazhduar t'i paraqesë si rekorde

edhe dështimet me inflacion ku, sipas tij, në bazë vjetore inflacioni ka qenë me rritje 4.9 %. Tutje ai tha se 100 euro të vitit 2020 sot kanë vlerën e 81,65 euro. Rukiqi ka folur edhe për eksportin. Ai tha se në vitin 2023 ka pasur 101 milionë euro më pak eksport se në vitin 2022.



Qytetarët e Kosovës gjatë muajit dhjetor morën 193 milionë euro kredi



PRISHTINË, 24 JANAR - Mbi 7.5 miliardë euro janë asetet e bankave komerciale në Republikën e Kosovës dhe se investimet e tyre jashtë vendit kanë arritur në 1.26 miliardë euro. Kështu thuhet në statistikën bankare për muajin dhjetor 2023, të publikuara nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK), duke shtuar se vlera e kredive bruto ka

arritur në 4.91 miliardë euro me një rritje prej 27.8 milionë eurosh, derisa shuma e depozitave të klientëve është 6.13 miliardë euro. Sipas raportit, kapitali i bankave komerciale për këtë muaj ishte 863 milionë euro. Vlera e kredive të reja në muajin dhjetor 2023 ishte 193.7 milionë euro, derisa shuma e depozitave

të reja arriti në 138.8 milionë euro. Po ashtu, norma mesatare e interesit në depozita ishte 3.14 %, ndërsa norma mesatare e interesit në kredi ishte 6.35 %, ku në muajin paraprak ishte 6.4 %. Raporti kredi-depozita për muajin dhjetor 2023 ishte në nivelin 80.2 %, kurse margjina e normës së interesit kredi - depozita ishte 3.2 %.

Bulliqi merr vendim për ndalimin e telefonave në shkollat e Podujevës

PODUJEVË, 24 JANAR - Kryetari i komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, ka marrë vendim për ndalimin e përdorimit të telefonave në shkollat e kësaj komune. "Bazuar në udhëzuesin nr.

20/2018 të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, kryetari i komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi ka marrë vendim për ndalimin e posedimit të

telefonit gjatë procesit mësimor nga nxënësit, mësimdhënësit, stafi profesional dhe punëtorët tjerë në mjediset - ambientet e institucioneve edukative-arsimore para universitar në

Komunën e Podujevës. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Drejtoria e Arsimit dhe Drejtoret e institucioneve të arsimit para universitar. Vendimi hyn në fuqi nga data 1 shkurt 2024".



Krasniqi pret në takim katër ambasadorë të huaj: PDK-ja do të jetë konstruktive

PRISHTINË, 24 JANAR - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, ka pritur të mërkurën në selinë e Partisë Demokratike të Kosovës shefin e Zyrës së BE-së në Kosovë, Tomas Szunyog, ambasadorin e Francës, Olivier Guerot, ambasadorin e Gjermanisë, Jorn Rohde dhe ambasadorin e Italisë, Antonello De Riu.

Krasniqi ka theksuar se PDK-ja do ta luajë rolin e saj konstruktiv që i shërben interesit qytetar dhe të ardhmes euroatlantike të shtetit tonë. “Në takimin e përbashkët diskutuam për zhvillimet e përgjithshme në vendin tonë, me theks të veçantë ato politike dhe të sigurisë. Ambasadorët evropianë i falënderova për përkushtimin dhe

kontributin e tyre për kultivimin e paqes, sigurisë dhe stabilitetit në Kosovë dhe i sigurova se edhe sot, kur Kosova po kalon nëpër sfida të natyrave të ndryshme, PDK-ja do ta luajë rolin e saj konstruktiv që i shërben interesit qytetar dhe të ardhmes euroatlantike të shtetit tonë”, ka shkruar Krasniqi në “Facebook”.



Kosova dhe Serbia do të vlerësohen individualisht nga Fondi i BE-së për rritje ekonomike

PRISHTINË, 24 JANAR - Fondet e Bashkimit Evropian për rritje ekonomike të Ballkanit Perëndimor mund të shfrytëzohen vetëm nëse respektohen kushtet dhe në rast të përdorimit të jashtëligjshëm të tyre, vendet do të detyrohen t'i kthejnë ato. Kështu ka deklaruar drejtori i përgjithshëm i BE-së në Negociatat për Zgjerim dhe Fqinjësi, Gert Jan Koopman, gjatë një diskutimi të zhvilluar të mërkurën në Komisionin e BE-së për Politikë të Jashtme dhe Buxhet.

Ai ka thënë se pagesat nga Plani për rritje ekonomike do të kryhen vetëm pasi të ketë dëshmi se janë ndërmarrë reformat e nevojshme. Nga gjashtë vendet e rajonit kërkohet të kenë plan të veprimit për reforma dhe përmbushja e tyre do të vlerësohet dy herë në vit. Duke folur për kushtet, ai ka përmendur sidomos sundimin e ligjit, respektimin e të drejtave të njeriut dhe respektimin e vlerave demokratike.

Koopman ka thënë se Kosova dhe Serbia do të kenë kushte specifike e ato lidhen me raportet mes tyre. “Kushtet specifike do të jenë për Kosovën dhe Serbinë, që të angazhohen në mënyrë konstruktive për normalizimin e raporteve. Kjo do të bëhet në mënyrë individuale për secilin nga këto dy vende. Me fjalë të tjera, nëse njëri vend nuk avancohet, vendi tjetër nuk do të pengohet nëse



avancohet në reforma”. Sipas Komisionit Evropian, gysma e mjeteve nga Plani për rritje në rajonin e Ballkanit Perëndimor do të shkojnë në kuadër të kornizës për investime, sepse mjetet ekzistuese që janë në dispozicion nuk janë të mjaftueshme për t'i kryer investimet e duhura. Pjesa tjetër do të shkojë në buxhetin e vendeve për të financuar disa nga reformat e

nevojshme. Koopman ka treguar se modeli do të jetë i thjeshtëzuar, për t’iu përshtatur Ballkanit Perëndimor, por duke respektuar edhe rregullat e BE-së. Komisioni Evropian beson se ky plan - nga i cili do të ndahen mjetet specifike për secilin vend - do të ndryshojë shumë rajonin e Ballkanit dhe do të jetë gjenerator për rritje të konsiderueshme ekonomike.

“Pa rritje të konsiderueshme ekonomike, rajoni i Ballkanit Perëndimor nuk do të mund të avancojë në arritjen e qëllimeve për integrim në BE”, ka thënë zyrtari i BE-së. Zyrtari i lartë i Komisionit Evropian ka sqaruar se një pjesë e mjeteve financiare do t’u jepen vendeve të rajonit si asistencë përkthim dhe një pjesë do të jetë në formën e kredive të favorshme. Ai ka thënë se këto kredi janë të domosdoshme, pasi vendet e

rajonit nuk kanë mundësi që në tregun ndërkombëtar të sigurojnë kredi me kushte të favorshme. Disa deputetë kanë kërkuar që nga këto mjetet të përfitojnë edhe ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, organizatat joqeveritare e jo që ato të përdoren për forcimin e strukturave politike. Mes të tjerash, është kërkuar që fondet të orientohen drejt adresimit të sfidave demografike dhe largimit të të rinjve.

Kritika të shumta në PE për zgjedhjet në Serbi

PRISHTINË, 24 JANAR - Shumë deputetë të Parlamentit Evropian kanë shprehur vërejtje dhe kritika të ashpra për procesin zgjedhor që u mbajt në Serbi në dhjetorin e vitit të kaluar dhe për zhvillimet edhe pas këtyre zgjedhjeve. Për situatën politike në Serbi është diskutuar më 23 janar në Komisionin për Politikë të Jashtme të Parlamentit Evropian. Aty folën edhe përfaqësuesit e Komisionit

Evropian dhe të Shërbimit të Veprimit të Jashtëm të BE-së (EEAS). Edhe ata thanë se zgjedhjet parlamentare, lokale dhe krahinore në Serbi, që u mbajtën më 17 dhjetor, nuk u zhvilluan në kushte të barabarta. Zëvendës drejtori menaxhues Marko Makovec, që foli në emër të EEAS-it, rikujtoi deklaratën e përbashkët të cilën e kishin dhënë përfaqësuesi i lartë Josep Borrell dhe komisionari për

Zgjerim, Oliver Varhelyi, se janë të shqetësuar për disa çështje që duhet të hetohen dhe adresohen dhe se janë të domosdoshme reformat. Makovec tha se sundimi i ligjit mbetet në qendër të procesit të anëtarësimit të Serbisë në Bashkimin Evropian. Ai rikujtoi se Serbia duhet t’i zbatojë të gjitha marrëveshjet e arritura në dialogun për normalizim të raporteve me Kosovën që ndërmjetësohet nga blloku evropian.



ShBA-ja kërkon rishqyrtim të vendimit për dinarin, Bislimi thotë se Kushtetuta duhet të zbatohet në tërësi



PRISHTINË, 24 JANAR - Shtetet e Bashkuara i kanë bërë thirrje Qeverisë së Kosovës ta rishqyrtojë vendimin e autoriteteve financiare për paratë e gatshme, ku është përmendur edhe dinari serb. Zëvendëskryeministri i Kosovës, Besnik Bislimi, ka thënë të mërkurën që Kushtetuta duhet të zbatohet në tërësi. Ditë më parë Banka Qendrore e Kosovës e ka miratuar një rregullore për operacionet me para të gatshme që parashihet euron si monedhën e vetme për kryerjen e transaksioneve. Kjo rregullore parashihet të hyjë në fuqi më 1 shkurt. Radio Evropa e Lirë e ka kontaktuar guvernatorin e BQK-së, Ahmet Ismaili, lidhur me kërkesën e ShBA-së, por nuk ka marrë ndonjë përgjigje. Në një konferencë për medie me ministrin për Çështje Evropiane të Republikës Çeke, Martin Dvorak, Bislimi ka insistuar në zbatim të Kushtetutës në të gjitha rastet. “Kur është fjala te neni 11 i Kushtetutës, që thotë ka vetëm

një monedhë në qarkullim në Kosovë, të njëjtët miq na thonë ‘po këtë mos e zbatoni’. Kushtetuta, ose është e shenjtë dhe duhet të zbatohet, ose pastaj bëjmë cherry picking [përzgjedhjen më të favorshme]. Nëse duhet të bëjmë cherry picking, po e bëjmë ne. Nëse duhet të zbatohet, atëherë insistoni që të zbatohet në të gjitha rastet”, ka thënë ai. Në Kosovë, në të gjitha vendbanimet me shumicë serbe, popullsia përdor dinarin serb për të kryer pagesa dhe ata që punojnë në institucionet serbe në Kosovë, i marrin edhe pagat me dinarë. Me dinarë paguhen edhe pensionet sipas sistemit serb si dhe shtesat për fëmijë dhe ndihmat sociale. Në objektet tregtare, në zonat ku banojnë serbët në Kosovë, përveç euros, përdoret edhe dinari. Një zëdhënës i Ambasadës Amerikane në Prishtinë i ka thënë Radios Evropa e Lirë se Qeveria e Kosovës duhet të konsultohet me komunitetet e

prekura nga ky vendim, t'i adresojë shqetësimet e shprehura prej komunitetit ndërkombëtar dhe të ofrojë kohë për zbatim të vendimit, për ta zbutur ndikimin që mund të ketë ai te banorët për të cilët vlen. “Ne jemi të shqetësuar që rregullorja e miratuar më 27 dhjetor do të ketë ndikim negativ te komuniteti serb në Kosovë. Sipas ligjeve të Kosovës, si dhe në bazë të zotimeve që ka marrë Kosova me Planin e Ahtisarit, Serbia ka të drejtë t’u dërgojë ndihmë financiare pjesëtarëve të komunitetit serb në Kosovë”. Plani i Ahtisaarit është dokumenti mbi bazën e të cilit është shpallur pavarësia e Kosovës dhe janë hartuar Kushtetuta dhe ligjet e Kosovës. Dinarët kanë ardhur në Kosovë nga Serbia përmes Bankës Kombëtare të Serbisë, e cila ka një kasafortë në Leposaviq, komunë në veri të Kosovës e banuar me shumicë serbe. Paratë atje janë transportuar nga kompania e transportit të parave “Henderson”. Në rregulloren e BQK-së është

thënë se importi dhe eksporti i kartëmonedhave dhe monedhave metalike euro dhe valutave të tjera në Kosovë janë e drejtë ekzekutive e saj. Zëvendëskryeministri i Kosovës, Besnik Bislimi, ka thënë se secili prej qytetarëve të Republikës së Kosovës që ka vepruar në kundërshtim me vendimin e BQK-së “ka qenë në vazhdimësi në anën e shkelësit të ligjit”. Ambasadori amerikan në Serbi, Christopher Hill, e ka quajtur vendimin e BQK-së “befasi të pakëndshme”. Lista Serbe - partia më e madhe e serbëve në Kosovë që gëzon mbështetjen e Beogradit zyrtar – ka thënë se ky vendim i “regjimit të Albin Kurtit” është “vendim për dëbimin e serbëve nga këto zona pa përdorimin e armëve”. Mes të tjerash, në reagim, Ambasada Amerikane ka rikujtuar pse Kosova duhet ta formojë Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë. “Asociacioni është mekanizmi primar përmes të cilit Serbia do të mund të ofronte ndihmë financiare për

institucionet dhe individët nën kornizën ligjore të Kosovës”. Sipas saj, “institucionet që ofrojnë shërbime kyçe - si arsimi dhe shëndetësia - duhet të jenë në gjendje të vazhdojnë të funksionojnë”. Kosova dhe Serbia kanë arritur marrëveshje për Asociacionin më 2013 dhe më pas më 2015 mbi parimet për themelimin e tij. Po më 2015, Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka gjetur se marrëveshja nuk është në harmoni të plotë me Kushtetutën. Serbia kërkon që Kosova t’i zbatojë marrëveshjet e arritura, por Qeveria e Kosovës është deklaruar kundër një asociacioni njëetnik. Asociacioni duhet të ofrojë një nivel të caktuar të vetëmenaxhimit për serbët në Kosovë. Në një draft-statut të hartuar nga Perëndimi për formim të Asociacionit, të cilin e ka parë Radio Evropa e Lirë, është paraparë mbështetja financiare nga Serbia për komunitetin serb në Kosovë përmes BQK-së.

Bordi i BQK-së emëron dy zëvendësguvernatorë

PRISHTINË, 24 JANAR - Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 24 janar ka emëruar dy zëvendësguvernatorë, duke kompletuar kështu Bordin Ekzekutiv, sipas Strukturës së re Organizative të miratuar në muajin nëntor 2024, bazuar në rekomandimet dhe praktikën më të mira ndërkombëtare. Përzgjedhja është bërë sipas

kërkesave të Ligjit të BQK-së përmes një procesi konkurrues dhe meritës, me propozim të guvernatorit. Zëvendësguvernatorët e emëruar Nesrin Shileku-Shala dhe Milot Cakaj do të jenë përgjegjës për fushën e mbikëqyrjes financiare, praktikën e tregut, rishqyrtimin dhe shërbimet e përgjithshme. Të tre zëvendësguvernatorët së bashku me guvernatorin

përbëjnë Bordin Ekzekutiv, vendimet e të cilit janë kolegjiale. Me përfundimin e këtij procesi plotësohen të gjitha strukturat vendimmarrëse të BQK-së të përcaktuara në Ligjin e BQK-së dhe Strukturën Organizative. Këto, ndër të tjera, ishin edhe kërkesat nga Programi i Fondit Monetar Ndërkombëtar si dhe rekomandime nga misionet e tij.



Nobelisti Arno Penzias: Historia e pabesueshme që e çoi tek Teoria e Big Bang-ut

Fizikani, fitues i çmimit Nobel, Arno Allan Penzias, kërkimi i të cilit çoi në konsolidimin e themeleve shkencore të të kuptuarit tonë për universin, ka vdekur në moshën 90-vjeçare. Ishte ai që konfirmoi teorinë e Big Bang-ut



Bota e fizikës po mban zi për vdekjen e fizikanit dhe astrofizikanit amerikan Arno Allan Penzias, i cili vdiq të hënën më 22 janar në një shtëpi të moshuarish në San Francisco, në moshën nëntëdhjetë vjeçare. Djali i tij David e dha lajmin për New York Times, duke specifikuar se shkaku i vdekjes ishin ndërlëkimet që lidhen me sëmundjen e Alzheimerit. Studimi i tij astronomik ndihmoi në sigurimin e dëshmimeve të padiskutueshme të thelbit dinamik, në zhvillim, të pikës së origjinës së universit, duke konfirmuar teorinë e Big Bang-ut si një shpjegim i pranuar gjerësisht i origjinës dhe evolucionit të kozmosit. Por jo vetëm kaq, falë kontributit të tij u konsolidua baza shkencore e të kuptuarit tonë të universit dhe puna e tij mbetet një shtyllë themelore në kozmologjinë moderne.

Historia e pabesueshme e jetës së tij

Bota mundi të njihnte gjenin e tij të madh falë një historie të pabesueshme që përfshiu familjen e tij në prag të Luftës së Dytë Botërore, kur së bashku me prindërit dhe vëllain më të vogël jetonin në Gjermaninë naziste, e cila shpejt do të shkaktohte atë pjesë të dhimbshme të historisë që të gjithë e njohim. Në prag të Luftës së Dytë

Botërore, një pronar dyqani bojërash në Belleville, New Jersey dëgjoi një trokitje të drojtur në derë. Ishte një emigrant gjerman 28-vjeçar i quajtur Leo Gelbart, i cili shkonte shtëpi më shtëpi duke kërkuar ndihmë nga anëtarët e komunitetit hebre të qytetit, në mënyrë që të sillte familjen Penzias, të përbërë nga Karl dhe Justine dhe djemtë e tyre Arno dhe Guenther, nga Gjermania, për t'i shpëtuar regjimit nazist. Për ta e vetmja alternativë ndaj kampit të përqendrimit ishte arratisja. Por për ta bërë këtë, atyre u nevojiteshin një sërë deklarimesh: dokumente zyrtare që vërtetonin ekzistencën e një të afërmi dhe një rrjet sigurie financiare në Shtetet e Bashkuara. Gelbart dyshohet se dha dokumentin e parë, duke pretenduar se miku Karl Penzias ishte kushëriri i tij. Por si kamarier nuk kishte para të mjaftueshme për të qenë garant financiar i familjes. Kështu ai po kërkonte dikë që të firmoste deklaratën e dytë dhe të merrte përgjegjësinë për familjen, nëse do të ishte e nevojshme.

Ndihma që ndryshoi historinë

Tregtari i bojërave pranoi t'i ndihmonte: "Do të jem i lumtur t'u jap një dorë derisa të jenë në gjendje të mbajnë veten," shkroi ai në deklaratë. Kështu, familja Penzias u shpërngul në Amerikë

nga Gjermania, jo me pak vështirësi, dhe Arno, djali i madh, u bë një nga fizikantët dhe astrofizikanët më të mëdhenj në botë. Në vitin 1978, së bashku me Robert Woodrow Wilson, ai fitoi Çmimin Nobel në Fizikë për zbulimin, në vitin 1964, të rrezatimit kozmik të sfondit mikrovalor, mbetjet e një shpërthimi që i dha jetë universit rreth 14 miliardë vjet më parë. Ai shpërthim, i njohur si Big Bang, është sot shpjegimi i pranuar gjerësisht për origjinën dhe evolucionin e universit.

Jeta e Arno Allan Penzias

Ai lindi në Mynih në vitin 1933, kur filloi ngritja e Hitlerit në pushtet. Në vitin 1938 familja u mbledh me hebrej të tjerë që mbanin pasaporta polake dhe u detyrua të hipnin në një tren për t'u larguar në Poloni. Por treni u vonua dhe zyrtarët polakë ua shpallën të pavlefshme pasaportat para se të arrinin në kufi. Në vitin 1939, ndërsa po nxitonin të organizonin nisjen për në Amerikë, prindërit e Arnos dërguan dy djemtë e tyre të vegjël në Angli falë Kindertransport, një nismë humanitare britanike falë së cilës u shpëtuan 10,000 fëmijë, kryesisht hebrej, nga territoret naziste.

Të dy kaluan nëpër familje të ndryshme kujdestare derisa Karl dhe Justine Penzias, falë ndihmës së marrë nga pronari amerikan i bojës, arritën të kishin të gjitha

dokumentet e nevojshme për t'u larguar për në Shtetet e Bashkuara. Thuhet se në udhëtimin me anije për të kaluar Oqeanin Atlantik, siç raporton National Geographic, ata u mbijetuan uraganeve të forta dhe sulmeve të nëndetëseve gjermane.

Mundësia për të qenë në gjendje të studionte


Me të mbërritur në Nju Jork, familja u vendos në Bronx dhe Arno ishte në gjendje të studionte në Shkollën e Lartë Teknike të Brooklynit, e të diplomojë në City College, duke përfunduar, pas shërbimit ushtarak, një doktoraturë në fizikë në Universitetin e Kolumbias. Më pas ai iu bashkua Bell Laboratories ku nga viti 1972 mbajti postin e drejtorit të departamentit të kërkimit të radiofizikës, duke punuar në projekte pioniere, përfshirë komunikimet satelitore dhe fibrat optike.

Ai gjithashtu dha mësim në universitete të shumta amerikane, duke përfshirë Princeton dhe Kembrixh. Ai u bë anëtar i Shoqatës Amerikane të Astronomisë dhe Shoqatës Amerikane të Fizikës, si dhe i Unionit Ndërkombëtar Astronomik. Në vitin 1965, ndërsa me Robert W. Wilson po përpiqej të reduktonte zhurmën e sfondit të pranishëm në komunikimet

me satelitët artificialë, ai zbuloi rrezatim të vazhdueshëm në 4.35 cm i cili, së bashku me rrezatimin e zbuluar pak më vonë në 20.7 cm, disponohej në një kthesë rrezatimi termik rreth 3°K. Për këtë zbulim, i cili përbën një nga të dhënat kryesore në mbështetje të teorisë kozmogonike të Big Bang-ut, të dy u nderuan me Çmimin Nobel për Fizikë në vitin 1978, së bashku me urimet e presidentit të atëhershëm Jimmy Carter. Pikërisht në përgjigje të atij telegrami ai i shkroi presidentit mirënjohjen, që pati mundësinë të jetonte në Shtetet e Bashkuara.

Fjalët prekëse

"Kam mbërritur në Shtetet e Bashkuara të Amerikës tridhjetë e nëntë vjet më parë pa para, si refugjat nga Gjermania naziste. Për mua dhe familjen time, Amerika përfaqësonte një strehë të sigurt, një vend të lirë plot mundësi. Në një kohë kur premtimet dhe rëndësia e institucioneve amerikane shpesh vihen në dyshim, ndihem i detyruar të dëshmoj se si është realizuar premtimi amerikan në përvojën time personale të jetës. Jam thellësisht krenar që jam amerikan dhe shumë mirënjohës për Amerikën dhe popullin amerikan. Përfitoj pra nga rasti, t'ju shpreh juve, si përfaqësues i popullit amerikan, një pjesë të vogël të falënderimit tim për të gjithë amerikanët". (bota.al)



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Temperatura apo politika: Pse nuk luajtën volejbollistët e Kosovës dhe Serbisë?



PRISHTINË, 24 JANAR - Federata e Volejbollit e Kosovës kërkoi nga Konfederata Evropiane e Volejbollit (CEV) që t'i verifikojë pretendimet e Serbisë se nëntë lojtarë kishin temperaturë dhe se, për këtë arsye, kombëtarja e të rinjve nuk e zhvilloi ndeshjen me Kosovën. Këtë lajm e bëri të ditur për Radion Evropa e Lirë, Bahri Gjinovci, kryetar i Federatës së Volejbollit të Kosovës.

Skuadra e volejbollit për meshkuj nën 18 vjeç e Serbisë nuk luajti një ndeshje kundër Kosovës më 21 janar në Strumicë të Maqedonisë së Veriut në kuadër të kualifikimeve për Kampionatin Evropian 2024. Ndeshja u regjistrua me rezultatin zyrtar 3:0 në favor të Kosovës dhe kadetët e Serbisë e mbyllën garën në vendin e gjashtë - gjë që i eliminoi nga kualifikimet e mëtutjeshme. Shpjegimi zyrtar ishte se nëntë lojtarë kishin temperaturë dhe kjo i pengoi të dilnin në fushë. "Kjo mund të ndodhë, por ne nuk e besojmë këtë [arsyetim]. Kemi kërkuar nga Konfederata Evropiane e Volejbollit të konfirmojë nëse janë dorëzuar raporte mjekësore, se vërtet ky ka qenë rasti apo nuk kanë dashur të luajnë kundër Kosovës", ka thënë Gjinovci.

Serbia nuk e njeh Kosovën shtet.

Nën ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian, dy vendet janë në negociata për normalizimin e marrëdhënieve të cilat duhet të rezultojnë me një marrëveshje ligjërish të detyrueshme. Federata e Volejbollit e Kosovës më 22 janar ka thënë se më shumë do t'i gëzohej suksesit të arritur në fushë sesa rezultatit të marrë "në tavolinë". "Sporti duhet të krijojë ura bashkimi, e Serbia, në këtë rast, ka dëshmuar përmes veprimeve të kësaj natyre, se akoma nuk e ka këtë vullnet e gatishmëri", u tha në deklaratën e saj.

Federata e Volejbollit e Serbisë i tha Radios Evropa e Lirë se ndeshja nuk u luajti, sepse nëntë lojtarë ishin me temperaturë të lartë. Sipas mjekut kujdestar, i cili përcaktohet nga vendi pritës, edhe delegatët është dashur ta konfirmojnë gjendjen shëndetësore të lojtarëve. Federata serbe nuk i komentoj pretendimet e Prishtinës, se vendimi për të mos luajtur ndeshjen me Kosovën mund të jetë politik. "Pasi përfundoi në vendin e gjashtë, ekipi kombëtar i Serbisë nuk e kaloi raundin tjetër [kualifikimin]", ka thënë për Radion Evropa e Lirë Konfederata Evropiane e Volejbollit.

Ndryshe nga Serbia, Kosova kaloi në fazën tjetër të kualifikimeve për Kampionatin Evropian 2024. Në

turneun kualifikues në Strumicë, Serbia është dashur të luftonte për vendin e pestë me Kosovën. Nikolla Janković, gazetar i Sport Klubit në Serbi, i ka thënë Radios Evropa e Lirë se kadetët serbë "janë përjashtuar nga i gjithë cikli kualifikues për moshën e tyre". "Djemtë e humbën shansin për të garuar në Kampionatin e ardhshëm Evropian dhe duke pasur parasysh se ai është kualifikues për Kampionatin Botëror, e humbën shansin për të garuar edhe në Kampionatin Botëror", ka thënë Janković. "Kadetët serbë do ta kenë shansin e ardhshëm për të garuar kur të jenë dy ose tre vjet më të vjetër", ka shtuar ai.

Konfederata Evropiane e Volejbollit dhe Shoqata Ballkanike e Volejbollit nuk iu përgjigjën pyetjeve të REL-it nëse e kanë marrë kërkesën e Kosovës dhe nëse do t'i hetojnë pretendimet e Serbisë për lojtarët e sëmurë. Vitet e kaluara, në disa raste, politika në mes të Kosovës dhe Serbisë ishte vendimtare në garat sportive të skuadrave të tyre. Dy lojtarë dhe një trajner me origjinë nga Serbia nuk morën pjesë në ndeshjen e Ligës Evropiane mes klubit sllovak Slovan Bratislava dhe klubit të futbollit Feronikeli në korrik të vitit 2019.

SHKURT

Superliga e Kosovës, e 43-ta në renditjen e IFFHS, Superiorja e Shqipërisë dy pozita më lart

Instituti për Histori dhe Statistika të Futbollit (IFFHS) ka publikuar së fundmi renditjen vjetore të ligave nacionale më të mira në botë. Në vitin 2023 Superliga e Kosovës e ka marrë një vend mjaft të lakmueshëm. Liga elitare e Kosovës ka përfunduar në pozitën e 43-të në renditjen që llogaritet nga 1 janari 2023 deri më 31 dhjetor të vitit që shkoi. Kosova ka përparuar për 13 pozita pasi liga e këtushme në vitin 2022 ishte në vendin e 56. Superliga e Kosovës u vlerësua me 402,75 pikë në vitin që sapo përfundoi. Pa dyshim suksesi i jashtëzakonshëm i Ballkanit në Ligën e Konferencës ka bërë që liga e Kosovës të ketë ngritje të madhe në këtë renditje. Ndërkaq, dy pozita përpara Superligës së Kosovës gjendet Superiorja e Shqipërisë, e cila është e 41-ta, me një përparim prej 25 pozitash pasi në vitin 2022 ishte e 66-ta. Superiorja e mbylli vitin 2023 me 410,5 pikë. Sa i përket renditjes së përgjithshme, Seria A italiane u shpall liga më e mirë në botë për të 12-ën herë në histori në renditjen e IFFHS-së që daton nga viti 1991.

Vokshi i pafat në lëshimin e dytë në Lojërat Olimpike Dimërore

Skitari nga Kosova Klos Vokshi ka garuar të mërkurën në Lojërat Olimpike Dimërore për të Rinj "Gangwon 2024". Vokshi garoi në disiplinën e sllallomit të madh, në të cilën ishte i pafat, pasi në lëshimin e dytë doli nga shtegu. Në lëshimin e parë doli i 54-ti prej 79 garuesve. Krahas tij, garën nuk e përfunduan edhe 29 skitarë të tjerë. Në disiplinën e njëjtë, por te vajzat, të martën garoi Lirika Deva, e cila doli e 31-ta. Vokshi e Deva janë skitarët e vetëm që po e përfaqësojnë Kosovën në LOD për të rinj, që po mbahen në Gangwon të Koresë së Jugut.

Marku: Kongo do të pendohet që zgjodhi të përballet me mua

Boksieri shqiptar Florian Marku dhe ai britanik Chris Kongo do të përballen në mars të këtij viti. Një sfidë që pritet me interes, sidomos pas sherrit që dy boksierët patën kur u përballën me njëri-tjetrin në një konferencë shtypi, në gusht të vitit të kaluar. Duke folur për incidentin e vjetër, boksieri i pamposhtur shqiptar Florian Marku ka thënë për "Sky Sports Boxing": "E dija se ai e donte atë luftë. Unë i thashë 'para se gjithash shko rrih djemtë që të rrahën' dhe vetëm atëherë eja dhe fol me mua. Ai nuk po shkonte dhe unë e shtyva". Marku e paralajmëroi rivalin britanik për sfidën mes tyre: "Do të pendohet. Do të pendohet që zgjodhi të luftonte me mua. Kur të jemi në ring, ai do ta kuptojë këtë". Pasi mposhti Dylan Moran në vetëm një raund, Marku ka kërkuar një duel të madh.

Kosova në shkurt mëson kundërshtarët e Ligës së Kombeve

Përfaqësuesja e Kosovës në futboll do t'i mësojë emrat e kundërshtarëve të Ligës së Kombeve të UEFA-s në pjesën e parë të shkurtit. Më saktësisht më 8 shkurt, "Dardanët" do të njihen me emrat e ekipeve me të cilët do të përfundojnë në të njëjtin grup. Kjo garë do të nisë në pjesën e dytë të vitit, më saktësisht më 5 shtator, ndërsa

në atë muaj Kosova do t'i zhvillojë dy ndeshje, dy të tjera në tetor dhe dy në nëntor. Kosova është pjesë e Ligës C të Ligës së Kombeve, ndërsa ka përfunduar në vazon e dytë bashkë me Bullgarinë, Azerbajxhanin e Ishujt Faro. Kjo nënkupton se nuk mund të përfundojë në të njëjtin grup me to. Kundërshtarë më të vështirë

mund të jenë Suedia e Rumania, që janë në vazon e parë, ku kanë përfunduar edhe Luksemburgu dhe Armenia. Ndërkaq, vazoja e tretë përbëhet nga Maqedonia e Veriut, Sllovakia, Irlanda e Veriut e Qipro dhe njëra prej tyre mund t'i bie në grup Kosovës, njëjtë si Bjellorusia, Letonia, Estonia, Lituania e Gjibraltari, që gjenden në vazon e katërt.



Verstappen: Kontrata me Red Bullin nuk më lejon të praktikoj sporte të rrezikshme

HASSELT, 24 JANAR - Piloti holandez Max Verstappen, tri herë kampion bote në Formula 1, në një intervistë për mediet ka rrëfyer se ai ka më shumë se pesë vjet që nuk praktikon sportin e skive. Kjo gjë i është ndaluar edhe me kontratë pilotit të talentuar, për të evituar

që të dëmtohet dhe të përfundojë si Michael Schumacheri. Verstappeni do të detyrohet të mos vendosë këmbë mbi ski të paktën deri në vitin 2028, kur dhe përfundon kontrata aktuale me Red Bull Racing. “Kam një klauzolë në kontratën aktuale me Red Bullin

që nuk më lejon të praktikoj sporte të rrezikshme apo ekstreme”, ka thënë kampioni i botës. “Një prej këtyre sporteve është ai i skive. Nuk arrij të bëj një garë me ski prej më shumë se pesë vjetësh, pasi rreziku që të dëmtohem është shumë i lartë në këtë sport”, u shpreh 26-

vjeçari, që arkëton 45 milionë euro në vit. Një vendim shumë strikt ky i Red Bullit, një markë që gjithnjë praktikon apo mbështet sportet ekstreme. Mjaft pilotë të tjerë të Formulës 1 nuk e kanë të ndaluar të bëjnë gara me ski gjatë pushimeve dimërore.



Kupa e Shqipërisë, favoritët kalojnë tutje

TIRANË, 24 JANAR - Asnjë surprizë në gjashtë ndeshjet e para të fazës së 1/8 në Kupën e Shqipërisë. Të gjitha ekipet favorite kaluan më tej, ndërsa në duelin në mes të dy ekipeve të elitës, Laçi - Dinamo, triumfoi ekipi i Mirel Josës me rezultatin minimal 1-0. Partizani mposhti me përmbysje Apoloninë, një ndeshje e cila u vendos në pjesën e dytë. Portieri Harizaj kaloi fierakët në avantazh teksa në tentativën e dytë nga pika e bardhë e penalltisë mposhti kapitenin Alban Hoxha. Të kuqtë e Orges Shehit iu përgjigjën menjëherë teksa Xhuliano Skuka realizoi një gol shumë të bukur, i pari për të në këtë rikthim në shtëpinë e kuqe. Për t'i mbyllur llogaritë me Apoloninë mendoi Mensah që sigloi shifrat përfundimtare në 3-



1. Një fitore të pastër 3-0 siguroi Tirana përballë Korabit duke siguruar një biletë për në çerekfinalet e Kupës së Shqipërisë. Lulaj, Latifi dhe Hoxhallari ishin autorët e golave. Me rezultatin e pastër 2-0 edhe

Egnatia likuidoi Lushnjën. Kalon më tej Kukësi, me verilindorët që mposhtën Elbasanin me rezultatin minimal 1-0. Nuk kishte surprizë as në sfidën Erzeni-Bylis, me shijakasi që kalojnë më tej pas fitores 2-1.

Clippersat fitojnë derbin me lakersat, Denveri dhe Oklahoma kryesojnë në Perëndim



LOS ANXHELOS, 24 JANAR - Skuadra e clippersave tregoi forcën në ndeshjen derbi ndaj lakersave, duke fituar me rezultat 127-116. Takim në përgjithësi i ekuilibruar e ku te lakersat u ndje mungesa e LeBron Jamesit. Më i miri për clippersat ishte Kawhi Leonard,

që realizoi një “triple double”, me 25 pikë, 11 rebounde dhe 10 asistime, mbështetur nga Hardeni me 23 pikë. Fitoi edhe ekipi kampion i Denverit, që mundi me rezultat 114-109 Indianan jashtë fushës. Edhe Nikola Jokiqi realizoi një “triple double”, me 31 pikë, 13

rebounde dhe 10 asistime, mbështetur edhe nga Murray po me 31 pikë. New York, falë 60 pikëve të dyshes Randle - Brunson, mundi me rezultat 108-103 Brooklynin. Në krye të renditjes në Perëndim ngjitet Oklahoma, që fitoi në sekondat e fundit me rezultat 111-109 ndaj Portlandit. Alexander Shai me 33 pikë dhe 10 asistime ishte lider për vendasit. Fitore të thellë arriti New Orleansi, që mundi me rezultat 153-124 Utah Jazzin, ndeshje ku dallimin në fushë e bëri McCollum, autor i 33 pikëve.

REZULTATET	
Indiana - Denver	109-114
Brooklyn - New York	103-108
New Orleans - Utah Jazz	153-124
Oklahoma - Portland	111-109
Clippers - Lakers	127-116

SHKURT

FC Ferizaj përforcohet me Stojcevskin

Mbrojtësi Stojan Stojcevski është përforcimi më i ri i FC Ferizaj. Stojcevski karrierën e ka filluar në FK Skopje, për të vazhduar në Vardar, Teteks, Rabotnički, Gostivar, Sileks. Së fundi mbrojti ngjyrat e Voska Sport. Për më tepër, Stojcevski ka qenë reprezentues i rregullt i Kombëtares së Maqedonisë së Veriut për grupmoshën U21. “Kjo goditje e përmbush nevojën që e kishim në vijën e mbrojtjes, gjë që ishte kërkesë edhe e stafit të trajnerëve në krye me Arsim Abazin. Me transferimin e tij, grupi i lojtarëve është pothuajse i kompletuar, me ç’rast skuadra të shtunën, më 27 janar, udhëton për Shqipëri për fazën përgatitore”, thuhet në njoftimin e skuadrës së Ferizajt.

Strakosha nuk e pranon rolin e rezervistit, projektohet rikthimi në Itali

“Kam Evropianin përpara, nuk erdha te Brentfordi vetëm për stolin”, ishte deklarata e bujshme e Thomas Strakoshës pak ditë më parë, duke shfryrë në një farë mënyre për qëndrimin e gjatë në stol dhe mundësinë e munguar për të qenë titullar te klubi anglez. Portieri i Kombëtares shqiptare, pasi nuk rinovoi me Lazion, kaloi në Premierë Ligë në verën e 2022-shit dhe sezonin e parë luajti vetëm dy ndeshje. Ndërkohë, pas largimit të portierit të parë Raja tek Arsenali, mbërriti Fleken nga Bundesliga dhe Strakosha sërish mbeti në stol. Kjo ka sjellë pakënaqësi, aq sa disa medie në platformën “X” kanë raportuar që disa klube në Serinë A janë të interesuara për 28-vjeçarin, i cili, nëse nuk gjen gjuhën e përbashkët me klubin, mund të huazohet në javën e fundit të merkatos.

Gana shkarkon trajnerin Hughton

Chris Hughton është shkarkuar nga pozita e trajnerit të Ganës pas eliminimit nga Kupa e Kombeve të Afrikës. “Yjet e Zi” përfunduan të tretët në Grupin B në turneun në Bregun e Fildishtë pas barazimit 2-2 me Mozambikun të hënën dhe humbën shpresat që ata kishin për një vend në fazën 1/16-të. “Shoqata e Futbollit e Ganës njofton se Chris Hughton është liruar nga detyra e tij si trajner i ekipit kombëtar me efekt të menjëhershëm. Këshilli Ekzekutiv ka vendosur ta shpërndajë stafin e trajnerëve të ‘Yjeve të Zi’”, thuhet në komunikatën zyrtare të federatës.

Barça vazhdon të jetë e interesuar për Silvën

Skuadra e Barcelonës vazhdon të jetë e interesuar për yllin e Manchester Cityt, Bernardo Silva. Sipas gazetës “Sport”, agjenti Jorge Mendes ka konfirmuar për gazetën “Record” në Portugali se Barcelona është ende e interesuar për nënshkrimin e Silvës. Futbollisti portugez verën e kaluar mund të largohej nga City për 65 milionë euro, derisa në verën që vjen mund të bëjë një gjë të tillë për 50 milionë euro. Për Barcelonën, një marrëveshje do të jetë e mundur vetëm nëse ata më në fund marrin një investitor që të fillojë të paguajë për shitjen e Barca Vision dhe me një ose dy shitje të mëdha këtë verë.

Bonucci: Synimi im është pjesëmarrja në Kampionatin Evropian

Ish-kapiteni i Italisë dhe Juventusit, Leonardo Bonucci, ka konfirmuar se një nga objektivat e tij kryesore për muajt e mbetur të sezonit 2023-2024 është të thirret nga Luciano Spalletti për Kampionatin

Evropian “Euro 2024” që do të zhvillohet në Gjermani. Tetë herë fituesi i Serisë A përfaqësoi për herë të fundit “Azzurrët” në humbjen 2-0 kundër Austrisë, në një ndeshje miqësore në nëntor të vitit 2022. Që atëherë ai

karrierën e vazhdoi duke u larguar nga Juventusit për t’iu bashkuar Union Berlinit, në një transferim si futbollist i lirë në verën e kaluar. Por, qëndërmbrojtësi italian bëri një lëvizje edhe në janar të këtij viti,

duke kaluar te Fenerbahçe. “Qëllimi im është të jem atje. Kam pasur një takim me Spallettin para transferimit. E di që nuk është një turne i lehtë. Ka vende të forta, por ne jemi kampionët në fuqi. Le të

shkojmë përsëri në Gjermani. Ne do të shkojmë ta mbrojmë titullin tonë. Gjithashtu dua të jem atje si pjesë e kombëtares. Të gjithë duan të jenë atje. Do të jap më të mirën nëse përfshihem”, ka deklaruar Bonucci.



Në bazë të nenit 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, nenit 4 të Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Kompania Rajonale e Mbeturinave (KRM) “Pastrimi” SH.A në Prishtinë shpall këtë:

KONKURS

Titulli i pozitës: Punëtor fizik – 20 pozita

Institucioni: Kompania Rajonale e Mbeturinave (KRM) “Pastrimi” SH.A – Prishtinë

Titulli i Mbikëqyrësit:/Raporton tek: Kryepunëtori

Orari i Punës: 40 orë në javë

Kohëzgjatja e emërimit: me afat të pacaktuar

Detyrat dhe përgjegjësitë: (përshkrim i shkurtër i detyrave kryesore)

- Kryen të gjitha punët fizike në mbledhjen dhe ngarkimin e mbeturinave, zbraszen e kontenjerëve dhe pastrimin e lokacionit rreth tyre;
- Sipas planit operativ dhe urdhëresës së punës bën fshirjen/pastrimin dhe larjen e rrugëve apo pastrimin e rrugës dhe trotuareve nga bora dhe akulli, hudhjen e kripës;
- Bën largimin e qenve dhe maceve të ngordhura dhe vendosjen e tyre në kontenjer;
- Është i obliguar që të ketë sjellje korrekte ndaj qytetarëve dhe shfrytëzuesve të shërbimeve;
- Është përgjegjës për përdorim të kujdesshëm të kontenjerëve dhe mjeteve të punës;
- Kryen dhe punë të tjera sipas urdhëresës së udhëheqësit.

Shkathtësitë e kërkuara: (aftësitë dhe shkathtësitë që kërkohen për këtë vend pune)

- Shkathtësi në komunikim dhe planifikim të punës;
- Aftësi bashkëpunimi, ndërpersonale si dhe pune në grup;

Kualifikimet arsimore, profesionale dhe përvoja e punës: (kualifikimet dhe përvoja që kërkohen për këtë vend pune)

- Diploma e shkollës fillore;

Konkursi është publikuar më datë 25 janar 2024 dhe mbyllet më datë 08 shkurt 2024.

APLIKACIONI: Në aplikacion duhet të bashkëngjiten dokumentet e nevojshme për konkurim, siç janë:

- Kopja e letërnjoftimit;
- Kopja e diplomës të shkollës fillore
- Çertifikata e lindjes
- Vërtetim që nuk jeni në hetime

MËNYRA E APLIKIMIT:

Formulari i aplikacionit merret dhe dorëzohet në arkivën e KRM “Pastrimi” SH.A, Rr. “Tahir Zajmi”, Nr.5, Prishtinë.

Aplikimi përmes postës: Aplikacioni i kompletuar me dokumente mund të dorëzohet edhe përmes postës në adresën: Rr. “Tahir Zajmi”, nr.5, Prishtinë, 10000. Aplikacionet e dërguara me postë duhet të mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim. Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijnë brenda 3 tri ditësh. Aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe ato të pakompletuara, nuk do të shqyrtohen fare.

KUSHTET E PJESËMARRJES NË KONKURS:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësi fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.

KRM “Pastrimi” SHA ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

VËREJTJE:

APLIKACIONET DHE DOKUMENTACIONI I PAKOMPLETUAR SIPAS KËREKSAVE TË PËRCAKTUARA NË KËTË KONKURS SI DHE ATO QË ARRIJNË PAS SKADIMIT TË AFATIT TË KONKURSIT, NUK DO TË SHQYRTOHEN.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Konkursi është i hapur 15 ditë, nga dita e publikimit.

Për informata më të rëndësishme mund të kontaktoni në nr. tel: +383 (0) 38 603 191



Prema članu 8. Zakona br. 03/L-212 rada, član 4 Upravnog uputstva br.07/2017 o regulisanju postupka konkurencije u javnom sektoru, Regionalno preduzeće za otpad (KRM) "Pastrimi" SH.A u kuranu, ovo je poruka:

KONKURS

Naslov pozicije: Fizički radnik – 20 pozicija

Institucija: Regionalno preduzeće za otpad (KRM) "Pastrimi" SH.A – Priština

Zvanje supervizora: Izveštaj: Glavni zaposleni

Radno vreme: 40 sati nedeljno

Trajanje zakazane obaveze: neodređeno vreme

Dužnosti i odgovornosti : (kratak opis glavnih zadataka)

- Obavlja sve fizičke zadatke u sakupljanju i utovaru otpada, istovaru kontejnera i čišćenju lokacije oko njih;
- Prema planu rada i redosledu rada, on pravi Pastrimi/Pastrimi i pranje puteva ili Pastrimi puta i pločnika od snega i leda, slanog belog luka;
- Uklanja mrtve pse i mačke i stavlja ih u kontejnere;
- Obavezno je imati korektno ponašanje prema građanima i korisnicima usluga;
- Odgovoran za pažljivo korišćenje kontejnera i alata za rad;
- Druge aktivnosti se obavljaju po komandi vođe.

Potrebne su veštine : (potrebne veštine i veštine za ovaj posao)

- Veštine komunikacije i planiranja rada;
- Saradničke, međuljudske veštine i timski rad;

Kvalifikacije za obrazovno, profesionalno i radno iskustvo: (kvalifikacije i iskustvo potrebno za ovaj posao)

- Diploma osnovne škole;

Konkurs je objavljen 25 januara 2024 godine, a zatvara se 08 februara 2024 godine.

Prijava: Prijava mora da sadrži potrebna dokumenta za konkurs, kao što su:

- Kopija ID-a;
- Kopija diplome osnovne škole
- Izvod iz matične knjige rođenih
- Dokaz da niste u istrazi

REŽIM APLIKACIJE:

Prijavni formular se uzima i podnosi arhivi KRM "Pastrimi" SH. A, "Tahir Zajmi" St., br.5, Priština.

Prijava poštom: Prijava kompletna sa dokumentima može se podneti i poštom na adresu: "Tahir Zajmi" St., br.5, Priština, 10000. Prijave poslate putem pošte treba da zadrže žig na pošiljki izvršenoj poslednjeg dana isteka roka za prijavu. Prijave poslate putem pošte, koje nose poštansku marku na pošiljki izvršenoj poslednjeg dana isteka roka za prijavu, smatraće se važećim i biće razmotrene ukoliko stignu u roku od 3 tri dana. Prijave koje stignu posle ovog roka i nekomplikovane uopšte neće biti razmatrane.

USLOVI UČEŠĆA NA KONKURSU:

Pravo na primenu imaju svi građani Republike Kosovo starosne dobi većine koji imaju punu sposobnost da deluju, poseduju građanska i politička prava, poseduju neophodnu obrazovnu pripremu i stručnu sposobnost obavljanja zadataka i koji poseduju fizičke veštine potrebne za obavljanje odgovarajućeg položaja.

KRM "Pastrimi" AD nudi jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Kosova i pozdravlja prijave svih muških i ženskih osoba iz svih zajednica na Kosovu.

UPOZORENJE:

PRIJAVE I NEKOMPATIBILNA DOKUMENTACIJA PREMA ZAHTEVIMA NAVEDENIM NA OVOM KONKURSU I ONIMA KOJI STIGNU PO ISTEKU ROKA KONKURSA NEĆE BITI RAZMATRANI.

Biće kontaktirani samo kandidati koji su ušli u uži izbor.

Konkurs je otvoren 15 dana od dana objavljivanja.

Za više informacija možete nas kontaktirati na br. Тел: +383 (0) 38 603 191



Në bazë të nenit 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, nenit 4 të Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Kompania Rajonale e Mbeturinave (KRM) “Pastrimi” SH.A në Prishtinë shpall këtë:

KONKURS

Titulli i pozitës: Automekanik – 5 pozita

Institucioni: Kompania Rajonale e Mbeturinave (KRM) “Pastrimi” SH.A – Prishtinë

Titulli i Mbikëqyrësit:/Raporton tek: Udhëheqësi i mirëmbajtjes së makinave

Orari i Punës: 40 orë në javë

Kohëzgjatja e emërimit: me afat të pacaktuar

Detyrat dhe përgjegjësitë: (përshkrim i shkurtër i detyrave kryesore)

- Kryen punët e servisimit dhe riparimit të të gjitha llojeve të automjeteve;
- Teston dhe kontrollon rregullsinë për mbajtje në gjendje të rregullt pune të automjeteve;
- Teston dhe provon rregullsinë e motorit, ndërruesit, boshtit rrotullues alternatorit, fyejve, përquesit, lyerjen e motorit, pastrimin e filtrave;
- Kryen dhe punë të tjera sipas urdhëresës së udhëheqësit të drejtpërdrejtë.

Shkathësitë e kërkuara: (aftësitë dhe shkathësitë që kërkohen për këtë vend pune)

- Shkathtësi në komunikim dhe planifikim të punës;
- Aftësi bashkëpunimi, ndërpersonale si dhe pune në grup;

Kualifikimet arsimore, profesionale dhe përvoja e punës: (kualifikimet dhe përvoja që kërkohen për këtë vend pune)

- Diploma e shkollës së mesme;
- Një (1) vit përvojë pune;

Konkursi është publikuar më datë 25 janar 2024 dhe mbyllet më datë 08 shkurt 2024.

APLIKACIONI: Në aplikacion duhet të bashkëngjiten dokumentet e nevojshme për konkurim, siç janë:

1. Kopja e letërnjoftimit;
2. Kopja e diplomës të shkollës së mesme;
3. Çertifikata e lindjes;
4. Vërtetim që nuk jeni në hetime.

MËNYRA E APLIKIMIT:

Formulari i aplikacionit merret dhe dorëzohet në arkivën e KRM “Pastrimi” SH.A, Rr. “Tahir Zajmi”, Nr.5, Prishtinë.

Aplikimi përmes postës: Aplikacioni i kompletuar me dokumente mund të dorëzohet edhe përmes postës në adresën: Rr. “Tahir Zajmi”, nr.5, Prishtinë, 10000. Aplikacionet e dërguara me postë duhet të mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim. Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijnë brenda 3 tri ditësh. Aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe ato të pakompletuara, nuk do të shqyrtohen fare.

KUSHTET E PJESËMARRJES NË KONKURS:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësi fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.

KRM “Pastrimi” SHA ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

VËREJTJE:

APLIKACIONET DHE DOKUMENTACIONI I PAKOMPLETUAR SIPAS KËREKSAVE TË PËRCAKTUARA NË KËTË KONKURS SI DHE ATO QË ARRIJNË PAS SKADIMIT TË AFATIT TË KONKURSIT, NUK DO TË SHQYRTOHEN.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Konkursi është i hapur 15 ditë, nga dita e publikimit.

Për informata më të rëndësishme mund të kontaktoni në nr. tel: +383 (0) 38 603 191



Prema çlanu 8. Zakona br. 03/L-212 rada, član 4 Upravnog uputstva br.07/2017 o regulisanju postupka konkurencije u javnom sektoru, Regionalno preduzeće za otpad (KRM) "Pastrimi" SH.A u kuranu, ovo je poruka:

KONKURS

Naslov pozicije: Automekanik – 5 pozicija

Institucija: Regionalno preduzeće za otpad (KRM) "Pastrimi" SH.A – Priština

Naslov supervizora: Izveštaj: Vođa održavanja automobila

Radno vreme: 40 sati nedeljno

Trajanje zakazane obaveze: neodređeno vreme

Dužnosti i odgovornosti : (kratak opis glavnih zadataka)

- Vrší servisiranje i popravku svih vrsta vozila;
- Testirajte i kontrolišite regularnost održavanja vozila u redovnom radnom stanju;
- Testira i testira regularnost motora, prekidače, rotacione sekire alternatora, uvrede, reflektore, farbu motora, Pastrimi filtera;
- Izvršavanje drugih zadataka u skladu sa redosledom direktnog lenjira.

Potrebne su veštine : (potrebne veštine i veštine za ovaj posao)

- Veštine komunikacije i planiranja rada;
- Saradničke, međuljudske veštine i timski rad;

Kvalifikacije za obrazovno, profesionalno i radno iskustvo: (kvalifikacije i iskustvo potrebno za ovaj posao)

- Diploma srednje škole;
- Jedna (1) godina radnog iskustva;

Konkurs je objavljen 25. januara 2024 godine, a zatvoren je 08 februara 2024 godine.

Prijava: Prijava mora da sadrži potrebna dokumenta za konkurs, kao što su:

1. Kopija ID-a;
2. Kopija diplome srednje škole;
3. Izvod iz matične knjige rođenih;
4. Dokaz da niste u istrazi.

REŽIM APLIKACIJE:

Prijavni formular se uzima i podnosi arhivi KRM "Pastrimi" SH. A, "Tahir Zajmi" St., br.5, Priština.

Prijava poštom: Prijava kompletna sa dokumentima može se podneti i poštom na adresu: "Tahir Zajmi" St., br.5, Priština, 10000. Prijave poslate putem pošte treba da zadrže žig na pošiljki izvršenoj poslednjeg dana isteka roka za prijavu. Prijave poslate putem pošte, koje nose poštansku marku na pošiljki izvršenoj poslednjeg dana isteka roka za prijavu, smatraće se važećim i biće razmotrene ukoliko stignu u roku od 3 tri dana. Prijave koje stignu posle ovog roka i nekomplikovane uopšte neće biti razmatrane.

USLOVI UČEŠĆA NA KONKURSU:

Pravo na primenu imaju svi građani Republike Kosovo starosne dobi većine koji imaju punu sposobnost da deluju, poseduju građanska i politička prava, poseduju neophodnu obrazovnu pripremu i stručnu sposobnost obavljanja zadataka i koji poseduju fizičke veštine potrebne za obavljanje odgovarajućeg položaja.

KRM "Pastrimi" AD nudi jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Kosova i pozdravlja prijave svih muških i ženskih osoba iz svih zajednica na Kosovu.

UPOZORENJE:

PRIJAVE I NEKOMPATIBILNA DOKUMENTACIJA PREMA ZAHTEVIMA NAVEDENIM NA OVOM KONKURSU I ONIMA KOJI STIGNU PO ISTEKU ROKA KONKURSA NEĆE BITI RAZMATRANI.

Biće kontaktirani samo kandidati koji su ušli u uži izbor.

Konkurs je otvoren 15 dana od dana objavljivanja.

Za više informacija možete nas kontaktirati na br. Тел: +383 (0) 38 603 191

Në mbështetje të Nenit 40 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare, Kuvendi i Shoqërisë Kullat e Latës Sh.P.K. në mbledhjen e datës 21.12.2023 nxjerrë këtë:

V E N D I M

Për zbritje të kapitalit

I. Miratohet zvogëlimi i kapitalit të përgjithshëm të shoqërisë, ashtu që kapitali i përgjithshëm i shoqërisë tregtare Alfa Projekt Sh.P.K. do të jetë:

Kapitali i shoqërisë do të jetë 399,500.00 € (me fjalë: treqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind euro), ku numri i aksioneve është 100 me vlerë nominale prej 3,995.00 € për aksion. Lloji i aksioneve: të thjeshta.

Pjesëmarrës në aksione të shoqërisë do të jenë aksionarët sipas pjesëmarrjes në përqindjen e aksioneve të kapitalit të zvogëluar të përgjithshëm si në vijim:

Ardiana Hasani - Mitrovicë, Rr. Avni Shabani B/5, Mitrovicë, pjesa në pronësi 57727.75 € apo në përqindje prej 14,45% të aksioneve të shoqërisë - Aksionar

Sadije Jashari - Prishtinë, Dardani Rr-Idriz Gjilani kurriz hy 8/7, Prishtinë, pjesa në pronësi 57727.75 € apo në përqindje prej 14,45% të aksioneve të shoqërisë - Aksionar

Arben Jashari - Mitrovicë, Sheshi Agim Hajrizi Nr 45/4/12,40000, Mitrovicë, pjesa në pronësi 284084.45 € apo në përqindje prej 71,11% të aksioneve të shoqërisë - Aksionar

II. Shtimi i kapitalit siç është përkufizuar me paragrafin I të këtij Vendimi, do të jetë i përfshirë në Statutin e shoqërisë në procedurën e ndryshimeve të shoqërisë sipas procedurave përkatëse.

III. Ky vendim hyjn menjëherë.

Mitrovicë, me datë 21 dhjetor 2023

Aksionarët

Arben Jashari

Sadije Jashari

Ardiana Hasani

A. Hasani

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Salih Morina shpall të pavlefshme Diplomën e Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina".

- Taulant Krasniqi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimanzit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Valbone Halilaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të sh. Fillore "Rilindja" Çifllak KK Rahovec.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.





TRADITË QË NGA 1992

